



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RAPORTI VJETOR

2014

Shkurt 2015

PASQYRA E LËNDËS

1.	HYRJE	4
2.	SITUATA E TRANSMETIMEVE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE	5
2.1.	Detyrimet financiare të OSHMA-ve	5
2.2.	Problematikat lidhur me mos përputhjet teknike të OSHMA-ve.	6
2.2.1	Problematika lidhur me Operatorët Audiovizive numerikë dhe analogë.....	6
2.2.2	Problematika lidhur me Operatorët Audio FM.....	8
2.2.3	Probleme të natyrës teknike të rrjeteve kablllore	8
2.2.4	Radiotelevizioni Publik	9
2.2.5	Kontrata e shërbimit të transmetimit publik	9
3	TRANSMETIMET KABLLORE.....	10
4	ECURIA E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT	14
4.1	Angazhimet e përbashkëta AMA - RTSH	14
4.2	Vlerësim paraprak i studimit për optimizimin e planit frekuencor.....	15
4.3	Procesi i licencimit të rrjeteve numerike sipas procedurës “beauty contest”	18
4.4	Koordinimi me vendet fqinje	19
4.5	Elementët financiarë të procesit.....	19
5	PROGRAMACIONI	21
5.1	Studio e Monitorimit.....	22
5.2	Përmbajtjet e transmetuara nga ofruesit e shërbimeve audiovizive	23
6	PROBLEMATIKA TË NATYRËS JURIDIKE	25
6.1	Ecuria e procesit të hartimit të akteve nënligjore	25
6.2	Njoftimi i ndryshimeve në të dhënat e subjekteve.....	27
6.3	Subjektet e paautorizuara nga AMA që janë identifikuar në transmetim.....	27
6.4	Çështjet gjyqësore.....	28
6.5	Vendimmarrja e AMA-s për detyrimet e mbartjes	28
7	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE	30
7.1	Burimet Njerëzore	30
7.1.1	Politikat e Rekrutimit.....	30

7.1.2	Trajnimet	31
7.1.3	Sistemimi në ambiente të reja	31
7.1.4	Marrëdhëniet me jashtë dhe publikun	31
7.2	Menaxhimi i burimeve financiare	32
7.2.1	Aktiviteti ekonomik-financiar	32
7.2.2	Realizimi i treguesve financiarë	32
7.2.3	Problematika të natyrës financiare	33
7.2.4	Realizimi i zërit “Të ardhura”	33
7.2.5	Realizimi i zërit “Shpenzime”	33
7.2.6	Shpenzime rrjedhëse.....	34
7.2.7	Pasqyrat financiare të operatorëve radiotelevizivë	34
8	Veprimtaria e AMA-s, nëntor 2014 – janar 2015	36

1. HYRJE

Vlerësimi për aktivitetin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA, për vitin 2014 është bazuar, në radhë të parë, në kuadrin e objektivave dhe funksioneve që ligji 97/2013 ka përcaktuar për këtë institucion, në përgjigje të zhvillimeve dhe problematikës në fluksin e transmetimeve audiovizive, risive teknologjike dhe mënyrës së konceptimit dhe performancës nga vetë grupet e interesit, por duke pasur si qëllim thelbësor respektimin e kërkesave dhe nevojave të audiencës. Nga ky këndvështrim, raporti vjetor që ju paraqesim, jo vetëm eidenton aspektet kryesore të realizimeve dhe mosrealizimeve, por ballafaqon dhe tregon rrethanat, shkaqet dhe përgjegjësitë konkrete për secilën hallkë të AMA-s, duke tentuar të shkojë dhe më tej: të prezantojë perspektivën e ndryshimit dhe përmirësimit të treguesve, duke e vendosur institucionin në pozitë aktive të një autoriteti rregullator, që jo vetëm monitoron, por dhe ndërhyr me efektivitet duke garantuar konkurrencën e ndershme në treg dhe duke u siguruar se transmetuesi publik është në drejtimin e duhur.

Në pjesën më të madhe të vitit 2014, AMA nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm të anëtarësisë për mbledhje dhe vendimarrje, një shkak që është reflektuar drejtpërdrejt në mospërmbyshjen e objektivave ligjore, pa mundur të miratojë akte nënligjore të domosdoshme me ndikim në aktivitetin normal të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive. Mungesa e funksionimit normal të autoritetit rregullator ka sjellë si pasojë vijimin e transmetimeve numerike apo analoge të palicencuara, rritjen pa kriter të numrit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari audio dhe/ose audiovizive, mungesën efektive të kontrollit të kushteve të licencës/autorizimit nga subjektet e fushës. Një tjetër problematikë e mprehtë, e hasur gjatë 10 muorit të parë të vitit 2014, por e mbartur nga vitet paraardhëse ka qenë pamundësia e ekzekutimit të vendimeve të AMA-s, duke ulur ndjeshëm autoritetin e institucionit në raport me subjektet shkelës. Pavarësisht pengesave të mësipërme, është arritur të miratohen vendime administrative që kërkojnë shumicë të thjeshtë, si trajtimi dhe shqyrtimi i ankesave të subjekteve të sanksionuar për kundërvajtje administrative, miratimi i ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence/autorizim në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një tjetër vendimarrje e rëndësishme ka qenë miratimi i Kodit të Transmetimit.

Kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike konsiderohet një proces shumë i rëndësishëm, për realizimin e të cilit shteti shqiptar ka marrë angazhime bazuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Autoriteti i Mediave Audiovizive është përgjegjës për administrimin e spektrit të frekuencave për transmetime audiovizive dhe mban rolin kryesor në këtë proces. Pikërisht edhe ky objektiv madhor ka marrë goditje, si nga periudha e gjatë e mosfunksionimit të institucionit gjatë vitit 2014, ashtu dhe nga mosrespektimi i ligjit mbi kontrollin e brezit frekuencor nga ana e administratës së AMA-s. Kjo ka rezultuar në zënien e brezit frekuencor në kundërshtim me ligjin.

2. SITUATA E TRANSMETIMEVE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE

Panorama e subjekteve që aktualisht ushtrojnë veprimtari audio dhe audiovizive në territorin shqiptar, paraqitet e ndarë në 72 subjekte audiovizive, 71 subjekte radiofonike dhe 3 subjekte me transmetime numerike tokësore.

Një pjesë jo e vogël e subjekteve veprojnë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Shkeljet më të prekshme të evidentuara nga këto subjekte lidhen me cenimin e dispozitave ligjore për shlyerjen e detyrimeve financiare si dhe kërkesave dhe kushteve teknike të transmetimit.

Subjekt me problematikë të përsëritur mund të përmendim televizionin Shijak TV të cilit i është bërë licenca e pavlefshme me vendim nr. 34, datë 01.02.2013, si rrjedhojë e përfundimit të afatit të licencës dhe mos përmbushje e detyrimeve financiare ndaj institucionit. Me vendim gjykate, AMA aktualisht është debitor ndaj subjektit në fjale në masën 116,289,989 Leke. Detyrimet e Shijak TV kundrejt AMA-s rezultojnë 4,184,000, ndërsa detyrime si sanksione me gjobe 119,600,000 Leke.

Në tabelat në vijim të këtij kapitulli janë paraqitur informacione mbi një ekstrakt prej 21 subjektesh, të cilët janë vlerësuar se kanë ndikim më të madh në publik dhe në tregun mediatik.

Më poshtë paraqesim në mënyrë të përmblodhur detyrimet financiare dhe shkeljet të karakterit teknik të këtij grupi subjektesh. Lista e plotë e subjekteve me problematikë të lartpërmendura paraqitet në shtojcën nr.1.

2.1. Detyrimet financiare të OSHMA-ve

Detyrimet financiare (pagesë vjetore për licencë, tarifa për shërbimet rtv) dhe sanksionet gjobë (në lekë)

Emërtim OSHMA	Licenca	Licenca vjetore e ndarë në vite			Tarifa shërb.rtv	Gjoba Total
	Total	2010-2012	2013	2014		
Tv ALSAT	16,673,100	5,557,700	5,557,700	5,557,700	984,000	
SuperSport	3,750,000		937,000	2,813,000		
Shoq Tring Tv	11,250,000	5,937,000	3,750,000	1,563,000		
Tv Sat Vizion +	7,350,000		3,600,000	3,750,000		500,000
Tv Top Channel	3,167,000			3,167,000		
Tv Shijak	2,645,600	2,645,600			1,538,400	119,600,000
Tv Koha	1,632,300	826,100	403,100	403,100	1,344,000	1,284,000
Tv News 24	260,500	260,500				
TV A1 Report					468,000	
Tv Planet						
Tv UTV Education						
Agon Channel						
Tv Adriamed						

Tv ABC News						
Tv Ora News						
Radio + 2	1,500,000		1,500,000			
Radio Top Albania						
Tv KLAN						
Shoq. Digitalb						
Shoq. Abcom						
Shoq. Albtelecom						
Total:	48,228,500				4,334,400	121,384,000

2.2. Problematikat lidhur me mos përputhjet teknike të OSHMA-ve.

2.2.1 Problematika lidhur me Operatorët Audiovizive numerikë dhe analogë.

Respektimi i kushteve teknike të transmetimit nga subjektet audio dhe audiovizive mbetet një nga detyrimet parësore të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi. Për të verifikuar respektimin e tyre, AMA, bazuar në kuadrin e brendshëm rregullativ dhe rekomandimet e ITU, duhet të kryejë monitorimin e transmetimeve audio dhe audiovizive të paktën dy herë në vit në gjithë territorin e Shqipërisë. Përgjatë periudhës raportuese, monitorimi nuk është kryer i plotë, duke lënë jashtë kontrollit disa zona të vendit. Shkaku kryesor i kësaj gjendjeje është mungesa e një plani vjetor monitorimi që parashikon burimet, mjetet dhe afatet për realizimin e monitorimit nëpërmjet qendrës së lëvizshme dhe afatet e raportimit. Po ashtu monitorimi është vështirësuar nga mungesa e disa instrumenteve të nevojshëm matës dhe monitorues. Vështirësi serioze ka shkaktuar emërimi, në mënyrë të përsëritur, në sektorët teknikë të institucionit, të personelit të pakualifikuar dhe jashtë profilit teknik.

Si rrjedhojë, informacioni që paraqitet në tabelat e mëposhtme, sidomos mbi mbulimin e zonave të licencimit, nuk është i plotë dhe i referohet disa inspektimeve të kryera gjatë vitit në bazë problematike dhe kryesisht matjeve të kryera në terren gjatë periudhës Dhjetor 2013 – Janar 2014, të kryera nga grupi teknik i punës ngritur me Urdhrin nr. 4086, datë 03.12.2013 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, “Për studimin e mundësisë për rritjen e numrit të mbulimeve me rrjete numerike tokësore”. Informacion më i detajuar mbi problematikat e konstatuara është paraqitur në shtojcën nr. 2.

Transmetime televizive numerike të paautorizuara

Emërtim OSHMA	Zonat ku ofrohet shërbim i palicencuar			
Digitalb	5 Rrjete Tiranë	4 rrjete në 7 pika të tjera transmetimi		
Top Channel	1 Rrjet Tiranë			
Tring TV	2 Rrjete Tiranë	1 në Kukës	1 në Peshkopi	1 në Burrel
TV Klan	1 Rrjet TR, DR, ELB			
TV Alsat	2 Rrjete Tiranë			

News 24	1 Rrjet Tiranë			
Ora News	1 Rrjet Tiranë			
TV Vision +	1 Rrjet Tiranë			
TV Saranda	1 Rrjet Sarandë			
Shijak TV	1 Rrjet Tiranë			

Kanalet dhe periudha e fillimit të transmetimeve numerike

Emërtim OSHMA	Kanali UHF	Periudha e daljes në transmetim
Digitalb	62, 64, 67, 69	2004
	29	2011
Tring TV	(Vizion +) 59	23.01.2008
	47	17.09.2008
	56	03.09.2012
Top Channel	51	01.07.2012
TV Klan	41	01.03.2012
TV Alsat	21, 66	02.07.2010
News 24	31	04.03.2013
Ora News	55	18.01.2013
TV Saranda	26	2010
Shijak TV	24	23.01.2008

Transmetime televizive analoge të pa licencuara

Emërtim OSHMA	Zonat ku ofrohet shërbim i pa licencuar						
TV Vision +	Tirane	Durrës	Shkodër	Korçë	Vlorë	Fier	Gjirokastrë
News 24	Shkodër						
UTV Education	Shkodër	Berat	Vlorë	Sarandë			
ABC News	Shkodër	Vlorë					
Ora News	Korçë						
TV Adriamed	Tiranë						
TV Klip	Patos						
TV Shijak	Transmetim pa licencë						

2.2.2 Problematika lidhur me Operatorët Audio FM

Mosdalje në transmetim sipas afateve ligjore
Radio Clazz
Radio Capital
Radio Living

Mosmbulim i plotë i zonës së licencimit
Radio ABC News
Radio Durrësi
Radio Univers
Radio Albania News
Radio +2
Radio Klan
Radio Travel
RFI (me përsëritës)
Radio BBC (me përsëritës)

Subjekte në transmetim pa licencë:
Radio New Planet
Radio Stinë
Radio Italia
Radio ABC
Radio Magic Star

Zgjerim zone pa autorizim:
Club FM

Ndërprerje transmetimi mbi 30 ditë në vit:
Radio Ime
Radio Greta
Radio Boom Boom

2.2.3 Probleme të natyrës teknike të rrjeteve kablllore

Në Shqipëri janë licencuar 109 operatorë kabllorë me zonë penetrimi nga një komunë, disa qarqe dhe kombëtare (Albtelecom). Pjesa më e madhe e rrjeteve kablllore mbështetet në teknologjinë e tejkaluar analoge. Aplikimi i kësaj teknologjie ka kosto të ulët dhe nuk kërkon kualifikim të lartë gjatë shfrytëzimit për një numër të vogël abonentësh. Nga ana tjetër, këto sisteme mbartin shumë të meta, të cilat me rritjen e numrit të

abonentëve bëhen pengesë për rritjen e mëtejshme të sasisë dhe cilësisë së shërbimeve. Mungesa e sistemit të kontrollit të abonentëve, pengon ngritjen e një sistemi faturimi, duke e bërë të pamënaxhueshëm krejt sistemin.

Krahas sistemeve kabllorë me teknologji të vjetëruar në Shqipëri tashmë ekzistojnë edhe operatorë që kanë ndërtuar rrjete kabllorë numerike të teknologjisë së fundit mbështetur në përdorimin masiv të kablove me fibra optike, duke përdorur standardet DVB-C, DVB-C2, dhe IPTV. Këta operatorë janë Abcom, Tring, etj.

AMA po punon për të përcaktuar strategjinë e zhvillimit të sistemeve kabllorë në Shqipëri, fillimisht duke përgatitur dhe miratuar specifikimet teknike të marrësve numerikë kabllorë.

2.2.4 Radiotelevizioni Publik

RTSH ka në funksionim 36 transmetues VHF, 29 transmetues UHF dhe një rrjet sekondar prej 210 përsëritësish. Gjatë periudhës raportuese, TVSH nuk ka njoftuar ndryshime apo shtesa në numrin e transmetuesve apo përsëritësve. Kombinimi i mbulimeve të realizuara nga transmetuesit, që emetojnë sinjal në VHF, transmetuesit e rrjetit primar në UHF dhe përsëritësve, bëjnë që mbulimi i territorit të Republikës me sinjalin e RTSH-së të arrijë në mbi 87%.

Problem kryesor, edhe gjatë këtij viti, vazhdon të mbetet bashkërendimi i punës me organet e pushtetit lokal për mirëmbajtjen e përsëritësve (mungesë godinash, linjash elektrike dhe pagesa kujdestarësh).

RTSH, për shkak të ndryshimit të kuadrit ligjor dhe zbatimit të Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, përgjatë vitit raportues, nuk ka kryer investime për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së mbulimit.

2.2.5 Kontrata e shërbimit të transmetimit publik

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, RTSH gjatë muajit prill 2014, në përputhje me afatin ligjor, ka paraqitur për miratim nga AMA, kontratën për shërbimin e transmetimit publik. Kjo kontratë nuk është miratuar nga AMA brenda afatit 30 ditor, siç parashikohet nga pika 3 e nenit 117, për shkak të mungesës së vendimmarrjes nga Këshilli i AMA-s.

Me rikthimin e vendimmarrjes, AMA është gati të shqyrtojë dhe miratojë kontratën e mësipërme, por nga vlerësimi i përmbajtjes së dokumentit të paraqitur nga RTSH, rezultojnë disa mangësi serioze, plotësimi i të cilave do ta kthejë kontratën në një dokument funksional për rregullimin e veprimtarisë së këtij institucioni si transmetues publik.

Në kontratën e shërbimit të paraqitur për miratim, përgjithësisht janë evidentuar çështjet themelore të veprimtarisë së RTSH-së, ashtu siç figurojnë në dispozitat e ligjit, pa realizuar detajimin dhe konkretizimin e tyre, duke sjellë si pasojë pamundësinë e evidentimit të përmbushjes nga ana e RTSH-së të detyrimeve kundrejt publikut.

3 TRANSMETIMET KABLLORE

Aktualisht, tregu mediatik audioviziv dominohet nga subjektet që ushtrojnë veprimtari televizive kabllore. Deri në muajin nëntor 2014 numri i subjekteve të autorizuar për këtë shërbim ka qenë 109. Në këtë kontekst, për të verifikuar zbatimin e ligjshmërisë nga këto subjekte, AMA ka investuar një pjesë të konsiderueshme të burimeve të saj njerëzore dhe administrative. Pavarësisht kësaj, rezulton se rreth 60% e këtyre subjekteve vijnë të ushtrojnë veprimtari duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto subjekte nuk respektojnë detyrimet primare që burojnë nga ligji si shlyerja e detyrimeve financiare ndaj AMA-s dhe sanksioneve gjobë, transmetimi i programeve pa gëzuar të drejtën e transmetimit dhe të drejtën e autorit, zgjerimi i paautorizuar i zonës së ofrimit të shërbimit, mosinformimi i AMA-s për ndryshimet që kanë ndodhur në të dhënat për marrjen e autorizimit etj.

Vlera e lartë e detyrimeve financiare dhe sanksioneve të pashlyera nga subjektet e ka përballur institucionin me një situatë të vështirë financiare duke ndikuar ndjeshëm në ecurinë normale të tij. Informacion i detajuar mbi detyrimet e subjekteve jepet në tabelën e mëposhtme.

Në rastet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative, subjektet janë ndëshkuar me sanksionet e parashikuara në ligj, megjithatë veprimtaria mbikëqyrëse e AMA-s, rast pas rasti është ushtruar në mënyrë selektive.

Gjatë periudhës raportuese konstatohet se ka pasur interes në rritje për pajisje me autorizim për ofrimin e shërbimeve të programeve audio/audiovizive që mbështeten në rrjete të ndryshme nga rrjetet tokësore analoge apo numerike. Përqindjen më të lartë të aplikimeve e zënë aplikimet për ripërsëritjen e programeve audio/audiovizive të të tretëve mbështetur në një rrjet kabllo. Nga muaji janar deri në dhjetor 2014, janë depozituar 43 aplikime për marrje autorizimi për ripërsëritjen e programeve audio dhe/audiovizive të të tretëve mbështetur në një rrjet kabllo, si dhe për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet apo në rrjet satelitor.

Në mbështetje të nenit 19, pika 1 germa “b” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, AMA lëshon autorizimet me shumicë të cilësuar. Neni 64, pika 5 e këtij ligji, përcakton se: “Autorizimi jepet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së plotësuar. Refuzimi i aplikimit bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar. Nëse AMA nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, nga data e marrjes së aplikimit të plotë, autorizimi konsiderohet i miratuar.”

Kjo kërkesë ligjore nuk është respektuar nga AMA për gjithë aplikimet e depozituara gjatë periudhës raportuese, pasi nuk është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit në afatet e duhura. Kështu për aplikimet e depozituara gjatë periudhës raportuese është shkelur afati 30 ditor i përcaktuar në këtë dispozitë ligjore për hapjen dhe shqyrtimin e tyre. Në mungesë të një vendimmarrjeje nga Këshilli i AMA-s, subjekteve aplikuese u lind e drejta për fillimin e ofrimit të shërbimeve, pasi sipas ligjit këto subjekte konsiderohen të autorizuar.

Nga ana tjetër, kjo procedurë lehtësuese e marrjes së autorizimeve është pasuar me rritjen pa kriter të numrit të subjekteve që ofrojnë shërbimin e ripërsëritjes së programeve audiovizive duke rritur shkallën e vështirësisë së institucionit për verifikimin e nivelit të zbatueshmërisë së ligjit nga këto subjekte.

Si rrjedhojë, krahas problemeve jashtëzakonisht të mëdha me subjektet e autorizuar ka vijuar dhënia e autorizimeve pa respektuar procedurat dhe dispozitat ligjore. Ligji shpreh qartë se pas hyrjes së tij në fuqi, AMA duhet të hartojë strategjinë e cila përcakton: "përfshirjen në një plan veprimi të AMA-s lidhur me numrin, qëllimin dhe natyrën e autorizimeve dhe/ose licencave, që propozon për të realizuar gjatë kohëzgjatjes që mbulon strategjia", pikë kjo e papërmbytur në shkelje të hapur të ligjit.

Subjektet të cilët janë autorizuar nga AMA për të ushtruar veprimtari audiovizive në zbatim të nenit 64 të ligjit të sipërcituar, pra me kalimin e afatit 30 ditor, për periudhën nga hyrja në fuqi e ligjit e deri në prill 2014 janë:

- 29 subjekte të autorizuar për ripërsëritjen e programeve audiovizive të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor;
- 4 subjekte të autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet satelitor, shërbim online.

Nisur nga problematikat e mësipërme, por duke mbajtur parasysh se zhvillimet teknologjike ofrojnë mënyra të reja të ofrimit të shërbimeve audiovizive, ka lindur si domosdoshmëri rishikimi i rregullores "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin nr. 3, datë 03.05.2013 të AMA-s. Me anë të këtij ndryshimi synohet të forcohen kërkesat kryesisht teknike që duhen përmbytur nga aplikantët për marrjen e autorizimeve. Po ashtu, në këtë rregullore do të përfshihen kërkesat dhe kriteret specifike për marrjen e autorizimeve për shërbimin IPTV, kur shërbimi ofrohet drejt abonentit fundor nëpërmjet adresave IP si dhe për autorizimin për ripërsëritjen online të shërbimit të programit audioviziv të të tretëve (OTT etj)/shërbimit të programit online audio/ripërsëritjen online të shërbimit të programit audio të të tretëve (OTT etj), shërbime të cilat nuk janë të përfshira në rregulloren ekzistuese.

Detyrimet financiare te subjekteve kabllorë

Emërtim OSHMA	Detyrimi (licencë) vitet 2010-2014	Detyrimi (gjobë) vitet 2010-2014
TV K Skai Digital	6,190,000	
TV K Albania Tirane	6,050,000	200,000
TV K Kombi	3,954,170	1,607,332
TV K Albania Durres	3,250,000	
TV K Epiri	3,050,000	
TV K Albania Shkoder	3,050,000	1,200,000
TV K Egnatia	2,375,000	300,000
TV K KL - ED	2,250,000	200,000
TV K Albania Kombi	2,150,000	
TV K Jug	2,045,830	4,100,000
TV K Info Cable	2,050,000	
TV K CA Elbasan North	1,600,000	1,000,000
TV K CA Elbasan South	1,500,000	1,000,000
TV K Apollnet	1,450,000	

TV K Albania Lushnje	1,250,000	
TV K Albania Gjirokaster	1,075,500	200,000
TV K Ordea	850,000	
TV K Bajrami Net	730,000	
TV K Envo Company	730,000	
TV K Krutje	600,000	830,000
TV K Kucova	533,000	1,000,000
TV K Best Cable	401,000	
TV K S3	400,000	1,400,000
TV K CA Permeti	400,000	600,000
TV K Terbuf	367,000	200,000
TV K Dushk	287,500	800,000
TV K Jesa	263,000	
TV K Fokus	204,000	
TV K Eris A&A	200,000	
TV K Ozuni	180,000	
TV K Luna	100,000	700,000
TV K 2ASL	50,000	200,000
TV K Maqellara	6,470	1,300,000
TV K Asparag		700,000
TV K Iliria		1,000,000
TV K Pupa		400,000
TV K Vlora Cable		1,800,000
TV K Shijak		600,000
TV K Pojan		900,000
TV K Roskovec		2,500,000
TV K Lissus		1,700,000
TV K Cakran		200,000
TV K Fraholli		1,900,000
TV K Mirdita		900,000
TV K Lezha		1,600,000
TV K Kukesi		800,000
TV K Delvina		1,200,000
TV K Delta		1,100,000
TV K Xhaci		2,500,000
TV K Prrenjas		1,000,000
TV K HB-CA		1,200,000
TV K Brado		120,000
TV K Danja		1,700,000
TV K Pirc		400,000
TV K Lin		1,000,000
TV K Ura Vajgurore		1,000,000
TV K Dire		1,000,000

TV K Devi		1,000,000
TV K M&G		1,200,000
TV K Mati		1,000,000
TV K Belsh		300,000
TV K Ir-Gen		200,000
Totali	49,592,470	47,757,332

4 ECURIA E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT

Autoriteti i Mediave Audiovizive është përgjegjës për administrimin e spektrit të frekuencave për transmetime audiovizive dhe mban rolin kryesor në procesin e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet digjitale. Megjithatë, funksionimi i autoritetit rregullator gjatë vitit 2014 nuk ka sjellë rezultatet e pritshme, si në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për mbylljen e transmetimeve analoge ashtu edhe për respektimin e kërkesave të parapara në ligjin organik si garantimi i konkurrencës së ndershme, mbrojtja e interesave të konsumatorit etj.

4.1 Angazhimet e përbashkëta AMA - RTSH

Me miratimin e ligjit “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” u hartua strategjia e kalimit në transmetimet numerike ku u përcaktuan angazhime të përbashkëta ndërmjet AMA-s dhe RTSH-së. Në këtë kuadër, AMA edhe gjatë vitit 2014 ka përgatitur shkresa me udhëzime veçanta për RTSH, ku janë përcaktuar detyrat e përbashkëta lidhur me realizimin e procesit të kalimit në transmetimet numerike:

1. **Përcaktimi i kriterëve dhe numrit të programeve me karakter publik që do të transmetohen hapur (pa pagesë) si dhe ato me akses të kushtëzuar.**

AMA, gjatë vitit 2014 ka ndërhyrë disa herë, qoftë shkresërisht, qoftë nëpërmjet organizimit të takimeve me drejtuesit e RTSH, për përfundimin e këtij procesi, por konstatojmë se akoma RTSH nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim në këtë drejtim.

2. **Parimet dhe kriteret e kontratave që do të lidhen midis RTSH-së dhe operatorëve privatë lokalë ekzistues për mbështetjen në rrjetin e operatorit publik.**

Deri më sot nga ana e Transmetuesit Publik nuk është propozuar ndonjë variant i kontratës tip, me gjithë ndërhyrjet e shpeshta të AMA-s me shkrim, në takime direkte dhe në takime të Komitetit Ndërinstitucional.

3. **Kriteret e përcaktimit të pagesave të operatorëve privatë ekzistues analogë për mbështetje në rrjetin numerik të TVSH dhe përcaktimi i pagesave për çdo kategori.**

Në strategji përcaktohet metodologjia e llogaritjes së pagesave që do të kryejnë operatorët analogë ekzistues për mbështetjen në rrjetin e RTSH-së.

Për këtë çështje, AMA ka ofruar ndihmën dhe sugjerimet e saj, si në takimet direkte ashtu edhe në mbledhjet e Sekretariatit Teknik, por i përket RTSH-së të përcaktojë tarifat për shërbimet që do t’u ofrojë operatorëve ekzistues analogë, të cilat do të miratohen më pas nga AMA. Deri më sot nga ana e Transmetuesit Publik nuk janë paraqitur zyrtarisht propozime mbi tarifat që parashikohet të aplikohen.

4. **Implementimi i rrjetit të parë numerik.**

RTSH duhet të depozitojë në AMA grafikun e implementimit të rrjeteve numerike. Për deri sa kontrata për ndërtimin e këtij rrjeti nuk është lidhur akoma, ky grafik nuk është hartuar ende.

5. Koordinimi me operatorët privatë lokalë për mbështetjen e tyre në Rrjetin numerik të RTSH-së.

RTSH duhet të koordinojë punën me operatorët privatë për përcaktimin e detajeve teknike të sjelljes së sinjaleve të tyre në qendrat e allotmenteve, caktimin e grafikut të përfundimit të linjave të operatorëve privatë si dhe për gjithë ecurinë e procesit. Ndonëse ndërtimi i rrjetit të RTSH nuk ka filluar akoma, koordinimi me operatorët private do të shmangë vonesat në implementim.

4.2 Vlerësim paraprak i studimit për optimizimin e planit frekuencor.

Me Urdhrin nr. 4086, datë 03.12.2013 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, u ngrit grupi teknik i punës, “Për studimin e mundësisë për rritjen e numrit të mbulimeve me rrjete numerike tokësore në përputhje dhe pa cenuar planin e frekuencave numerike të Miratuar nga Marrëveshja GE-06”.

Ky grup pune përbëhej nga përfaqësues të MIAP, AMA, AKEP, RTSH, Top Channel, TV Klan, Vizion Plus, Tring, Digitalb dhe nga Ing. Artan Xhori.

Konkretisht, detyra kryesore e këtij grupi pune ishte hartimi i një projekti të ri për mire menaxhimin e frekuencave duke synuar plotësimin e nevojave të tregut gjatë kalimit në transmetimet numerike.

Gjatë periudhës dhjetor 2013 – Janar 2014 u kryen matje në territorin e vendit me qëllim mbledhjen e të dhënave paraprake që do të përfshiheshin në studimin për optimizimin e përdorimit të planit frekuencor.

Mbledhja përmbyllëse e këtij grupi pune u zhvillua në datë 18.06.2014, ku përfaqësues të një nga operatorëve të grupit të punës, Digitalb, propozuan nën përgjegjësinë e tyre përgatitjen e një studimi për optimizimin e frekuencave.

Studimi i përgatitur nga operatori në fjalë, “Për optimizimin e frekuencave për rrjetet DVB-T2” iu dërgua Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike në datë 28.10.2014 e cila, gjithashtu e përcolli për vlerësim pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në datë 06.11.2014. Gjatë së njëjtës periudhë, ky studim i është dërguar për vlerësim dhe Byrosë së Telekomunikacionit të ITU.

Bazuar në dispozitat e Ligjit 97/2013 mbi Administrimin e Planit Frekuencor, gjatë muajit janar 2015 u krye nga specialistë të AMA-s një shqyrtim paraprak i studimit të optimizimit të Planit Frekuencor të përgatitur nga kompania Digitalb.

Gjithashtu, në datë 29.01.2014 ITU ka dërguar përgjigje me komentet dhe vlerësimet e kryera nga ITU mbi studimin.

Më poshtë paraqitën në mënyrë të përmbledhur vlerësimet e AMA dhe të ITU:

Vlerësimet e AMA-s mbi studimin për optimizimin e planit frekuencor.

Nga materiali i paraqitur rezultoi se në përgjithësi është prodhuar një material serioz me cilësi të lartë teknike dhe me konkluzione të bazuara.

Qëllimi i këtij studimi është shtimi i rrjeteve kombëtare duke rezultuar në nëntë të tilla, nga pesë që mundëson plani aktual.

Kjo përbën avantazh të konsiderueshëm për tregun e transmetimeve audiovizive numerike pasi, siç përcaktohet dhe nga ligji i Mediave Audiovizive 97/2013, lejon “legalizimin” e operatorëve historikë kombëtarë dhe me eksperiencë në transmetimet numerike. Në këtë mënyrë mundësohet, nga njëra anë, përmbushja e kërkesave e këtyre operatorëve dhe nga ana tjetër shtohen hapësira për anti monopolizimin e tregut audioviziv numerik. Gjithashtu ky studim, në asnjë rast nuk prek hapësirën e operatorit publik.

Në vlerësim u shtjelluan disa raste, të cilat duhet të vlerësoheshin nga një ekspertizë e certifikuar që të përcaktonin nevojat për koordinim me vendet fqinje nëse mund të hasen interferenca. Për këtë qëllim, AMA do të kërkoje nga organizmat ndërkombëtare si, KiE dhe OSBE ekspertë të fushës për të kryer një vlerësim sa më transparent lidhur disa aspekte teknike, si më poshtë:

- Në material, si element kryesor për shtimin e rrjeteve është përdorur zgjerimi i rrjeteve SFN, duke shfrytëzuar karakteristikat më të mira të rrjeteve DVB-T2. Kjo është në përputhje edhe me rekomandimet e ITU për të krijuar zona të gjera mbulimi. Çështja qëndron tek koordinimi me vendet fqinje sidomos në disa raste kur parashikohen allotmente shqiptare në të njëjtën frekuencë me allotmentet e vendeve fqinjë ngjitur me ta (CH 22 i planifikuar për allotmentin e ri Fier Vlore, përdoret edhe në allotmentin grek ngjitur me të, CH 27 në allotmentin e Dibrës, përdoret edhe në allotmentin maqedonas ngjitur me të).
- Në studim, përveç metodës së përshkruar më sipër, është parashikuar përdorimi i frekuencave që përfshihen në planin numerik shqiptar, por i përkasin allotmenteve jo fqinjë me allotmentet ku parashikohen të përdoren (kanali 27 në Dibër dhe kanali 53 në Kukës).
- Nga 9 rrjetet kombëtare të përcaktuara në studim, 8 rrjete janë parashikuar të kenë 2 lloj parametrash (Modulimi, Code rate, Carrier mode, GI, PP4). Aplikimi i këtij propozimi do të sillte kapacitete të ndryshëm të rrjeteve në allotmente të ndryshëm. Në rrjetin e parë kombëtar do të kishte një diferencë prej 12 Mbps që të mbetej e pashfrytëzuar. Në rrjetet e tjera ndryshimi i GI, përsëri sjell reduktimin e kapacitetit nga 36.6 Mbps në 32.1 Mbps. U vlerësua se kalimi nga 24 Mbps në 36 Mbps mund të arrihet nëpërmjet koordinimit me administratën italiane, duke zbatuar rregullat dhe normat e përcaktuara nga GE-06.
- Meqenëse studimi në fjalë ka përdorur metodologji deterministike (duke konsideruar edhe kushtet e ambientit, kurbaturën e tokës, etj,) i mbetet ekspertizës më të kualifikuar për të vendosur nëse llogaritja e interferencave përtej kufirit prej 500 km është e nevojshme, sipas specifikave të nxjerra nga GE06.
- Përfundimisht specialistët e drejtorisë teknike ishin të mendimit paraprak se studimi, me disa sqarime që do të bëhen nga grupi i ekspertizës, pas diskutimit në detaj të të dhënave dhe parametrave teknikë, është i aplikueshëm teknikisht për planifikimin e rrjeteve numerike të Shqipërisë.

Komentet nga ITU mbi studimin për optimizimin e planit frekuencor.

Ministrja e Inovacionit dhe Administratës Publike, z.Milena Harito i ka drejtuar Drejtorit të Byrosë së Radiokomunikacioneve në ITU z. F.Rancy një letër ku, pasi e informon mbi progresin e procesit të kalimit në transmetimet numerike në Shqipëri, i kërkon që Byroja e Radiokomunikimit të komentojë mbi rezultatet e studimit mbi optimizimin e frekuencave, të ndërmarrë nga një nga operatorët privatë audiovizivë në Shqipëri.

Në përgjigjen e tij, Z. Rancy komenton:

1. Ndryshimet e propozuara ndaj parametrave teknikë të frekuencave në dispozicion tashmë të shënuara në Planin Dixhital GE06 (GE06D), të rekomanduara nga studimi i optimizimit të frekuencave, lejohen nga marrëveshja GE06 me kushtin e përmbushjes së suksesshme të dispozitave kryesore, konkretisht nenit 4 dhe 5 të marrëveshjes.
2. Vihet re se disa nga ndryshimet e propozuara janë sinjifikative, konkretisht:
 - a) Mënyra e marrjes, nga mobile/portable (RPC2) në fikse (RPC1)
 - b) Standardet e transmetimit nga DVB-T në DVB-T2
 - c) Agregimi (Bashkimi) i zonave të allotmenteve ekzistues për t'u mbuluar nga një Rrjet me Frekuencë të Vetme (SFN)
 - d) Rishikim të të gjitha caktimeve frekuencore dhe allotmenteve tashmë të përcaktuara në plan.
3. Metoda e planifikimit të përhapjes e përdorur në studim është e ndryshme nga ajo e përcaktuar në Kreun 2 (Informacioni mbi përhapjen) të marrëveshjes GE06.
4. Gjatë planifikimit të punës në territorin e vet për sa i përket shërbimeve Televizive, Administrata është e lirë të vendosë një planifikim përhapjeje të përshtatshëm. Përdorimi i metodës GE6 nuk është i detyrueshëm.
5. Gjatë punës së koordinimit të përdorimit të frekuencave Televizive me administrata të tjera, Administratat janë të lira të vendosin planifikimin e përhapjes së përshtatshme. Përdorimi i metodës GE6 nuk është i detyrueshëm.
6. Sidoqoftë, gjatë aplikimit të dispozitave të Marrëveshjes siç është identifikimi i administratave që konsiderohen se afektohen (preken) nga këto ndryshime (4.1.2.8, 4.1.2.2 dhe 4.1.2.3), duhet të përdoret metoda GE06 për planifikimin e përhapjes.
7. Në identifikimin e shërbimeve që mund të afektohen, studimi aplikon një rreze koordinimi prej 500 km (faqja 32) në vend të asaj prej 1000 km siç parashikohet në seksionin 2.1 të aneksit të Marrëveshjes.
8. Studimi konsideron që përmbushja e kushteve për koordinim ndërkombëtar plotësohet në rast se vlerat trigger të intensitetit të fushës nuk tejkalojnë përcaktimet e bëra tashmë nga ITU në Planin GE06D. Kushtet e përcaktuara nga studimi përshkruhen në faqen 32:
 - a) Rrezja e koordinimit ishte 500 km për Shqipërinë
 - b) Vendet e përfshira në kalkulim ishin Italia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Greqia, Maqedonia dhe Kosova
 - c) Janë marrë në konsideratë vetëm caktimet frekuencore të regjistruara në ITU (nuk përmendet si janë trajtuar allotmentet).
 - d) Vlerat trigger të intensitetit të fushës të GE respektohen në të gjitha llogaritjet.

9. Qasja e mësipërme e përdorur gjatë studimit nuk është në përputhje me procedurat e përcaktuara në nen-seksionin 2.1 të seksionit 1 të aneksit 4 sipas përmbledhjes së mëposhtme.
 - a) Të gjitha vendet kufijtë e të cilëve ndodhen apo ndërpriten nga konturi 1000 km merren në konsideratë.
 - b) Për shërbimet e transmetimit, çdo administratë e identifikuar në pikën a) si më sipër do të konsiderohet si e përfshirë dhe si pasoje pëlqimi (pranimi) prej të cilëve kërkohet nëse konturi i koordinimit (intensiteti trigger i fushës) ndërpret apo përfshin kufijtë kombëtarë të kësaj administrate. Është e rëndësishme të vihet në dukje se në mënyrë që të përcaktohet që një administratë ndikohet apo jo, intensiteti trigger i fushës llogaritet në kufijtë kombëtarë të saj, jo në vendndodhje apo në kufijtë e zonës së mbulimit të frekuencës së përcaktuar dhe të regjistruar në planin GE06D.

Ne përmbledhje, modifikimet e propozuara ndaj planit si rezultat i studimit lejohen dhe mund të paraqiten për t'u proceduar në përputhje me nenin 4 të Marrëveshjes. Në varësi të llogaritjeve të detajuara, duke pasur parasysh numrin e lartë të ndryshimeve domethënëse të propozuara ndaj Planit të rekomanduara nga studimi, është e pritshme që nevojitet të kryhen veprimtari substanciale koordinimi midis administratës suaj dhe administrative të tjera që mund të ndikohen, përpara se modifikimet e propozuara të regjistrohen në Plan dhe stacionet respektive të kalojnë në operim.

Në mënyrë që të shtyhet përpara procesi i koordinimit, rekomandohet që administratë juaj të procedojë si më poshtë:

1. Të përgatisë njoftime (notifikime) elektronike për të gjitha ndryshimet e propozuara.
2. Të parashtrijë lajmërimet elektronike një Byro për trajtim sipas Nenit 4 të Marrëveshjes.
3. Pas marrjes së lajmërimeve elektronike, Byroja do të publikojë modifikimet e propozuara bashkë me emrat e administrative që konsiderohet të ndikohen në një Seksion Special si pjesë e BR IFIC në mënyrë që të kërkojë komentim zyrtar nga administratat që përfshihen potencialisht.
4. Administrata juaj koordinon me administratat e ndikuara dhe bën ndryshimet ndaj modifikimeve të propozuara sipas nevojës.
5. Me marrjen e të gjitha miratimeve nga ana e administrative të afektuara, paraqitni në Byro specifikimet teknike përfundimtare mbi modifikimet e propozuara për t'u regjistruar në Plan.
6. Lajmëroni Byronë kur caktimet frekuencore vihen në punë, në mënyrë që ato të regjistrohen në Regjistrin Themeltar për të siguruar njohje dhe mbrojtje ndërkombëtare.

4.3 Procesi i licencimit të rrjeteve numerike sipas procedurës “beauty contest”

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ka përcaktuar afate konkrete për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to. Ky proces vijon të jetë i bllokuar për shkak të vazhdimësisë së proceseve gjyqësore.

Gjykata Administrative e Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me objekt anulimin e akteve administrative të miratuara nga AMA për zhvillimin e procedurës së licencimit sipas “*beauty kontest*”, në datën

09 tetor 2014, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë. AMA ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe çështja është ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Pavarësisht sa më sipër, AMA duke konsideruar se digjitalizimi i rrjeteve analogë tokësore përbën një prej objektivave primarë të Strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, prej muajit janar 2015 ka nisur një proces konsultimi me subjektet historikë kombëtare dhe ata me eksperiencë në transmetimet numerike për marrjen e mendimit të tyre si palë të interesuara, për ndryshimin e kërkesave financiare (kapitalit dhe garancisë bankare) të rregullores.

Pas marrjes së mendimit të tyre AMA do të procedojë me miratimin e ndryshimeve përkatëse në rregulloren e licencimit sipas “*beauty contest*” dhe më pas do të shpallë konkurrimin për licencimin e rrjeteve numerike private kombëtare dhe programeve që mbështeten në to.

4.4 Koordinimi me vendet fqinje

Edhe përgjatë periudhës raportuese ka vijuar procesi i koordinimit me vendet fqinje që i shërben procesi të kalimit në transmetimet numerike.

Në datat 20 dhe 21 mars 2014, në Romë u mbajt takimi dypalësh me Departamentin e Komunikacioneve të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Italisë. Objekti i takimit ishte këmbimi i eksperiencës reciproke mbi procesin e digjitalizimit, përdorimi i brezave të dividendit digjital dhe koordinimi i frekuencave midis dy vendeve tona.

Pala italiane u shpreh se mund të gjendet një zgjidhje e kënaqshme për të dy vendet, duke i dhënë Shqipërisë të drejtën e përdorimit të kanaleve që do të identifikohen për zëvendësimin, por duke ruajtur statusin e kanaleve të caktuara nga GE06 për Italinë.

Pala shqiptare u shpreh gjithashtu e gatshme, për të shqyrtuar mundësinë e miratimit të kërkesave italiane për koordinimin e kanaleve të tjera me të njëjtat kushte.

Pala shqiptare sinjalizoi shumë raste të interferencave në transmetimet radio FM të shkaktuara nga stacionet italiane. Pala italiane mori përsipër të informojë inspektoratet kompetente për marrjen e masave përkatëse.

Në rast se procesi i filluar i koordinimit me Italinë përfundon pozitivisht, ashtu siç edhe pritet, bazuar në dispozitat e marrëveshjes GE-06, ky proces duhet të vazhdojë edhe me koordinimin me vendet e tjera brenda distancës së koordinimit, por sidomos me vendet fqinjë si Mali i Zi, Kroaci, Slloveni, Kosovë, Serbi, Bosnje e Hercegovinë dhe Greqi, të cilat preken më tepër nga transmetimet italiane dhe shqiptare.

4.5 Elementët financiare të procesit

Realizimi me sukses i procesit të kalimit në transmetimet numerike kërkon bashkëpunimin e të gjithë strukturave shtetërore. Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike”, në Planin e Veprimit parashikon një sërë detyrash që duhen përmbushur nga AMA për ndjekjen e zbatimin e saj.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, me urdhër të brendshëm nr. 147, datë 08.08.2014, “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e Planit të veprimit për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”, përcaktoi aktivitetet e institucionit për implementimin e Planit të veprimit.

AMA në mënyrë të përsëritur gjatë vitit 2014 ka kërkuar nga Ministria e Financave akordimin e fondeve të nevojshme për realizimin e detyrave emergjente që rrjedhin nga plani i veprimit:

- Konferenca rajonale e kombëtare;
- Krijimi i “call center” pranë AMA-s;
- Organizimi i fushatës për informimin e publikut.

5 PROGRAMACIONI

Drejtoria e Programeve me tre sektorët përbërës: studion e monitorimit, të informacionit dhe të reklamave, si dhe sektorin e programeve, ka në fokus performancën e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive, publike dhe private, sa i takon përmbajtjeve që transmetojnë, cilësinë dhe llojshmërinë e tyre, për të përmbushur sa më mirë interesat e përdoruesve të tyre. Gjatë vitit 2014, aktiviteti i Drejtorisë në përgjithësi ka qenë i orientuar nga zbatimi i detyrave dhe procedurave rutinë, duke shqyrtuar aplikime për licencim e autorizim të subjekteve të interesuar; duke ndjekur dhe analizuar vetëm ato raste problematike për të cilat ka pasur ankesë ose pretendim nga jashtë institucionit për shkelje të të drejtës së transmetimit, për përmbajtjet e ofruara.

Ka munguar ana tjetër e këtij angazhimi, që do të thotë se nga Drejtoria nuk ka pasur iniciativa të saj për t'u marrë me probleme reale të OSHMA-ve, që lidhen me përmbajtjet e transmetuara, sa ato përmbushin detyrimet e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe akteve nënligjore të miratura, në respektimin e parimeve themelore të ushtrimit e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, siç janë shkeljet e të drejtës së privatësisë, keqpërdorimit të gjuhës dhe prezencës së dhunës në ekran, keqpërdorimit të fjalorit dhe gjuhës në disa programe argëtuese, transmetimit të filmave e programeve pa shenjat paralajmëruese shkeljet etike në reklamat, në komunikimet e ndryshme tregtare etj., në plotësim të angazhimit për informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit.

Ka munguar vetëveprimi për të monitoruar dhe evidentuar raste të mosrespektimit të kriterëve për të cilat subjektet janë licencuar, nëse ato vijnë të ofrojnë katalogun e programeve të prodhuara vetë, si dhe për zbatimin rigoroz të kontratave për të drejtën e transmetimit për programet e ritransmetuara – të dyja këto probleme evidente në tregun e transmetimeve audiovizive.

Në plotësimin e kuadrit ligjor, gjatë vitit 2014, Drejtoria e Programeve u angazhua në përgatitjen dhe miratimin e akteve nënligjore që rrjedhin nga zbatueshmëria e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Njëri prej akteve kryesore që u arrit të miratohej nga Këshilli i AMA-s ishte Kodi i Transmetimit, votuar më 27 janar 2014, publikuar i plotë në faqen zyrtare të institucionit. Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazik mbështetet në parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, në standardet më të arrira profesionale bashkëkohore, në normat dhe kërkesat morale dhe etike, si dhe në praktikën e deritanishme të veprimtarisë audiovizive në vendin tone; në nxitje dhe ndërgjegjësim të OSHMA-ve, për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në transmetimin e programeve në përputhje me respektimin e lirive e të drejtave themelore të njeriut, me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të të miturve, respektimin e privatësisë, dinjitetit, pluralizmit, paansisë etj.

Në seksione të vecanta Kodi përfshin aspekte mbi programet informative; transmetimet audiovizive dhe interesin publik; të drejtën e privatësisë; mbrojtjen e të miturve; aksesin dhe kujdesin për personat me aftësi të kufizuara; promovimin e veprave europiane dhe veprave të pavarura etj.

Tri rregullore të tjera: për transmetimin e mesazheve me interes të lartë për publikun; për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes dhe rregullorja për komunikimet audio dhe /ose audiovizive me natyrë tregtare dhe reklamat janë ende në formën e drafteve, duke kërkuar diskutime më të thelluara në finalizimin e tyre. Pavarësisht këtyre

rezultateve konkrete në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore gjatë vitit 2014, Drejtoria e Programeve në vijim ka ende punë me plotësimin e kuadrit të akteve nënligjore, në bashkëpunim dhe me departamentet e tjera të AMA-s, të tilla si, rregulloret për promovimin dhe prodhimin e veprave Europiane; për regjistrimin e transmetimeve; për udhëzuesin elektronik të programeve etj.

5.1 Studio e Monitorimit

Një prej detyrave funksionale që kryen AMA sipas ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” është monitorimi në tërësinë e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive. Rolin kryesor në këtë aspekt e kryen Studio e Monitorimit, strukturë e Drejtorisë së Programeve. Gjatë vitit 2014, Studio ka vijuar të ketë si kapacitet maksimal mbajtjen në regjistrim të njëkohshëm të 15 subjekteve audiovizivë: tre televizionet me licencë kombëtare TVSH, Top Channel e Klan; dy radiot kombëtare Radio Tirana dhe Top Albania Radio, si dhe operatorë lokalë ose rajonalë që shihen ose dëgjohen në Tiranë. Në dy nga kompjuterat regjistruar të studios janë vizionuar dhe kanale nga platformat digitale DigitAlb Satelitor, Tring Satelitor dhe Abcom.

Target kryesor për monitorimin e përmbajtjeve në Studion e Monitorimit ishin:

- edicionet kryesore informative;
- reklamat;
- detyrimet programore.

Nëse do t’i përshkruanim përmbledhtazi statistikisht, këto të dhëna kanë qenë:

- monitorimi i programeve së bashku me ndërprerjet publicitare të subjekteve televizive, në lidhje me detyrimet programore në total rreth 6200 orë programe të monitoruara;
- monitorimi i reklamave të transmetuara nga subjektet televizivë kombëtarë, në total rreth 5300 orë programe të monitoruara;
- rreth 1260 edicione informative (900 edicione të subjektet televizivë kombëtarë dhe 360 të subjekteve radiofonike kombëtare) për periudhën Janar - Tetor 2014;
- monitorime të subjekteve radiofonikë rreth 60 orë transmetimi;
- monitorime për të drejtat e transmetimit dhe të drejtat e autorit rreth 500 orë transmetimi;
- monitorime të subjekteve me përmbajtje muzikore rreth 30 orë transmetimi.

Studio e Monitorimit është në gjendje të prapambetur të inventarit teknologjik (kompjuterat aktualë janë rinovuar në vitin 2009), për pasojë mjaft nga proceset e punës së skedimit dhe analizimit të materialeve të vizionuara realizohen në mënyrë manuale, duke kërkuar kohë të konsiderueshme. Gjatë vitit 2014, nuk ka pasur kujdes sistematik për mbarëvajtjen e soft-it, duke e lënë shërbimin ndaj tij në zgjidhje spontane. Prej dy viteve

nuk është zgjidhur problemi i mungesës në rrjet të UPS-it për përballimin e ndërprerjeve të energjisë elektrike, të cilat japin ndikim negativ direkt në çorientimin e server-ave duke ndërprerë regjistrimin e përmbajtjeve, sipas grafikut ditor të parashikuar.

Një defekt në programin e Studios së Monitorimit, në fillim të muajit nëntor, shkaktoi fshirjen e të dhënave të hedhura nga specialistët e monitorimit dhe të sektorit të informacionit, të dhëna që pjesërisht u rikuperuan pas dy muajsh kur u riinstalua programi i ri. Menaxhimi dhe dëmtimi i programit në studion e monitorimit shërbeu për drejtuesit e AMA-s që të angazhohen, në dy muajt e fundit të vitit 2014, jo vetëm për rivënien në punë, por dhe për të ndërtuar një strategji të mirëmenduar për të gjithë infrastrukturën teknologjike të Studios së Monitorimit, në mënyrë që:

- të përshtatet funksionalisht duke u modernizuar për t'iu përgjigjur procesit të kalimit të transmetimeve audiovizive nga analoge në numerike;
- të ofrohet ekspertizë dhe precedent i ngjashëm nga vende të tjera për të dizajnuar dhe arregtuar Studion sipas standardeve bashkëkohore dhe në përputhje me dinamikën e tregut shqiptar të transmetimeve;
- shërbimi dhe aktualizimi i të gjithë sistemit informatik në Studio të ketë zgjidhje të qëndrueshme dhe të përgjegjshme për personelin që është pjesë e tij, duke shmangur rastet e gabimeve, ose dëmtimeve që sjellin pasoja të rënda në database, si rasti i përmendur i fillimit të muajit nëntor 2014;
- përshtatja e personelit të Studios së Monitorimit me risitë e inventarit teknologjik dhe proceseve të reja, si dhe të synohet që monitorimi dhe skedimi i përmbajtjeve të ketë në fokus dhe elementët paraprakë të analizës apo vlerësimeve për to.

Zgjidhja e qëndrueshme dhe afatgjatë për Studion e Monitorimit ka qenë pjesë e diskutimeve që AMA ka zhvilluar me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare me përfaqësim në Shqipëri, si OSBE, BE, Këshilli i Europës etj.

5.2 Përmbajtjet e transmetuara nga ofruesit e shërbimeve audiovizive

Gjatë vitit 2014, ka vijuar monitorimi i edicioneve informative, i cili përmban kohën e vënë në dispozicion nga subjektet audiovizive (në edicionet kryesore informative), për veprimtaritë e partive politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura, aktorët e ndryshëm politikë, veprimtaritë social-ekonomike, etj. Po ashtu pasqyrohen të dhëna të hollësishme mbi prezencën sinkron të personaliteteve politike dhe shtetërore. Gjatë monitorimit janë përcaktuar edhe të dhëna lidhur me vendin që kanë zënë në edicionet e lajmeve tema të tilla si politika, lajmet ndërkombëtare, ekonomia, veprimtaritë e Parlamentit, të qeverisë, arsimit, arti dhe kultura, kronika e zezë, shëndetësia, kriminaliteti, biznesi, sporti, etj.

Në perspektivën e monitorimit dhe analizimit të pjesës informative për subjektet audiovizive dhe audio me licencë kombëtare po shikohet bazueshmëria e praktikës së deritanishme për të pasur në fokus edicionin kryesor informativ të tyre. Por në ndryshimet teknologjike dhe përmbajtësore në tregun e transmetimeve radiotelevizive ky format informativ nuk është me të njëjtin kuptim si vite më parë, ndaj dhe pjesa e

monitorueshme për ndonjërin prej subjekteve kombëtare do të rishikohet, për të arritur te hapësira e vërtetë informative sa më përfaqësuese.

Në shtojcën nr. 3 jepen në mënyrë të përmbledhur tabelat e monitorimit (në përqindje) për katërmujorin e tretë të vitit 2014 (shtator-dhjetor) për tre transmetuesit kombëtarë televizivë Televizioni Publik Shqiptar, Televizioni Klan dhe Televizionin Top Channel, sa i takon kohës që ato u kanë kushtuar në edicionet kryesore të lajmeve:

- subjekteve politike dhe institucioneve qendrore;
- sinkronet për këto subjekte dhe institucione;
- sinkronet për aktorët e spektrit politik;
- tematika e informacioneve që janë pëfshirë në edicion.

Legjislacioni për mediat audiovizive në Shqipëri, i hartuar dhe i përafruar me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizive 2010/13/BE, AVMSD, ka sjellë ndryshime dhe përmirësime në fushën e rregullimit të transmetimeve të medias elektronike, si dhe në plotësim të kuadrit të nevojshëm rregullator për ligjshmërinë e transmetimit të reklamave. Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, përcakton rregulla të qarta dhe të detajuara për transmetimet e komunikimeve audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare dhe kërkesat e AVMSD-së janë reflektuar plotësisht në ligj, duke sjellë një gamë më të gjerë të llojeve të reklamave, duke përmendur këtu “Dritaret e teleshitjeve”, “Vendosjen e produktit” etj.

Perspektiva e Drejtorisë së Programeve lidhet me kalimin e saj nga pozitat e qëndrimit pasiv ndaj problematikës (duke u angazhuar më shumë kur ka ankesa apo kërkesa nga jashtë institucionit për përmbajtjen e programeve të subjekteve audiovizive) në pozitat aktive. Kjo do të arrihet dhe përmes:

- verifikimit të grilave programore dhe përmbajtjeve kryesore për të cilat subjektet audiovizive janë angazhuar në momentet e aplikimit për licencë ose autorizim, ose gjatë procesit të rimarrjes së tyre;
- kryerja e studimeve/analizave të fokusuara për aspekte të rëndësishme të përmbajtjeve programore: mbrojtja e të miturve, transmetimi i filmave ose i programeve me përmbajtje seksi, dhune etj., pa shenja paralajmëruese dhe në fasha orare të papërshtatshme, aksesit për personat me aftësi të kufizuara etj.
- përqendrimi tek trajtimi i rasteve të keqpërdorimit të gjuhës shqipe, banalitetet dhe qëndrimet joetike në përmbajtjet e programeve/spektakleve argëtuese etj.

Konstituimi dhe fillimi i punës nga Këshilli i Ankesave, sipas përcaktimeve që janë bërë në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, do të jetë një mbështetje shumë e madhe konkrete për Drejtorinë e Programeve sa i takon identifikimit, ndjekjes dhe analizimit të problemeve që hasen në përmbajtjet e transmetuara, që lidhen kryesisht me etikën e komunikimit audioviziv, por edhe me çështje të raporteve delikate midis të drejtës për informim dhe të drejtës për privatësi, për përparësinë e mbrojtjes së interesit publik, për respektimin e dinjitetit të individit dhe një sërë çështjesh të tjera që kanë nevojë për mendim të kualifikuar, e për zgjidhje profesionale dhe institucionale.

6 PROBLEMATIKA TË NATYRËS JURIDIKE

6.1 *Ecuria e procesit të hartimit të akteve nënligjore*

Përgjatë periudhës raportuese, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar punën për hartimin e paketës së akteve nënligjore në zbatim të kërkesave të ligjit. Bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 97/2013, procesi i hartimit të akteve nënligjore i është nënshtruar konsultimit të gjerë publik. Ky proces nuk ka dhënë rezultatet e pritshme, pasi subjektet audio dhe/ose audiovizivë kanë treguar interes të pakët për dhënien e mendimeve për aktet e propozuara. Një nga shkaqet e mungesës së interesit të tyre ka qenë mungesa e besimit në trupën vendimmarrëse të autoritetit rregullator, si dhe klima negative e krijuar mes AMA-s dhe operatorëve me ndikim të ndjeshëm në tregun mediatik.

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndonjë zhvillim pozitiv për të plotësuar kuadrin ligjor me legjislacion sekondar.

Duke mos miratuar paketën e akteve nënligjore, AMA ka shkelur afatet e parashikuara në ligjin nr. 97/2013, i cili në nenin 141 të tij parashikon se: “AMA ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja e tij në fuqi me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në ligj.”

Më poshtë renditen aktet nënligjore të cilat janë hartuar, por që nuk janë miratuar:

1. Projektregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”;
2. Projektregullore “Për kriteret dhe masat rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së”;
3. Projektudhëzim “Për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim”;
4. Projektregullore “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”;
5. Projektregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv dhe licencës së shërbimit të programit audioviziv”;
6. Projektregullore “Për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale”;
7. Projektregullore “Mbi procedurat e rinovimit të licencave të transmetimit audio”;
8. Projektregullore “Mbi ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar”;
9. Projektregullore “Për planin e renditjes së shërbimeve mediatike audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”;

10. Projektregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”;
11. Projektregullore “Për transmetimin pa shpërblim të mesazheve me interes të lartë për publikun e gjerë”;
12. Projektregullore "Për përcaktimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe dhe mënyrën e transmetimit të tyre dhe të drejtën e raportimit të lajmeve të shkurtra".

AMA aktualisht është në fazën e hartimit të akteve të tjera rregullatore që parashikohen në dispozita të veçanta të ligjit organik. Gjatë përgatitjes së këtyre akteve do të analizohet situata aktuale e transmetimeve dhe do të merren në konsideratë praktikatat më të mira ndërkombëtare për të garantuar që shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve dhe për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve shqiptarë. Aktet që pritet të hartohen gjatë vitit në vijim renditen më poshtë:

Kodi i sjelljes për veprimtarinë e AMA-s. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit për anëtarët e AMA-s dhe administratën. Detyrimi për miratimin e këtij akti buron nga neni 7 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i cili përcakton rastet e papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesave të anëtarëve të AMA dhe nëpunësve të tij.

Rregullorja e brendshme e AMA-s. Në këtë akt do të parashikohen rregullat për thirrjen e mbledhjeve të AMA-s, rastet e thirrjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme, përcaktimi i tematikave të mbledhjeve, procedurat e marrjes së vendimeve, forma e votimit etj. Po ashtu, ky akt do të përcaktojë detyrat funksionale të drejtorive, sektorëve, marrëdhëniet midis drejtorive të AMA-s, rregullat e komunikimit midis drejtorive. Bazuar në nenit 13, pika 5 të ligjit nr. 97/2013, Ky akt propozohet nga kryetari dhe miratohet nga AMA me shumicë të cilësuar.

Strategjia për ofrimin e shërbimeve të transmetimit, në të cilën duhet të përcaktohet mënyra e realizimit të funksioneve të AMA-s. Afati i përcaktuar në ligj për miratimin e këtij dokumenti strategjik është tejkaluar pasi ligji përcakton që ky akt duhet të miratohet brenda 5 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit. Në këtë dokument do të përfshihen qëllimet kryesore dhe aktivitetet në përmbushje të objektivave të AMA-s, duhen mbajtur parasysh nevoja e përdorimit sa më efektiv të burimeve të veta. Ligji kërkon që procesi i hartimit dhe miratimit të Strategjisë për ofrimin e shërbimeve të transmetimit ti nënshtrohet një procesi të gjerë konsultimesh ku aktorë të ndryshëm të kenë mundësi të paraqesin propozime dhe sugjerime mbi të. Po ashtu, ligji kërkon që në përgatitjen e strategjisë të merren në konsideratë kërkesat e Kuvendit, sugjerimet e Ministrisë të Linjës si dhe mendimet e organeve të tjera publike si AKEP, Autoriteti i Konkurrencës, ZSHDA apo Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Në këtë dokument do të përfshihet edhe një plan veprimi në të cilin do të përcaktohen numri, qëllimi dhe natyra e autorizimeve/licencave që propozohet të miratohen përgjatë një periudhe 3 vjeçare.

Miratimi i Strategjisë do të shërbejë për ushtrimin sa më të përshtatshëm të funksioneve të AMA-s:

1. Rregullorja “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe ushtrimin e të drejtës së përgjigjes”;
2. Rregullorja “Për rregullat dhe procedurat e licencimit të transmetimit audio te komunitetit”;

3. Rregullorja “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimit për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit.

6.2 Njoftimi i ndryshimeve në të dhënat e subjekteve

Njoftimi i ndryshimeve në të dhënat e subjekteve ka si qëllim vënien në dijeni dhe njohjen e autoritetit rregullator me çdo ndryshim të të dhënave që i licencuari/i autorizuari ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës/autorizimit, të tilla si: ndryshimet në pronësi, që është nga më të rëndësishmit, ndryshimet në administrimin apo drejtuesin e shoqërisë, emrin e transmetuesit, përmbajtjen e programeve që transmeton, selinë e adresën e subjektit, dhe të tjera ndryshime që kanë të bëjnë me kushtet me të cilat dhe për të cilat një subjekt i caktuar është licencuar.

Gjatë vitit 2014, Këshilli ka marrë në shqyrtim njoftimet për ndryshimet e ndodhura në subjektet e licencuar/autorizuar (4 subjekte).

Duke pasur parasysh kërkesën e mësipërme ligjore, AMA me shkresat nr. 1376 prot., nr. 1377 prot., dhe nr. 1378 prot., datë 13.11.2014 u ka kërkuar gjithë subjekteve audio dhe/ose audiovizivë të depozitojnë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive kopje të ekstraktit të përditësuar historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit. Shkresës së mësipërme i janë përgjigjur 42 televizione kombëtare/vendore nga 72 subjekte audiovizivë në total, 39 radio kombëtare/lokale nga 71 subjekte audio në total, 71 subjekte televizionë privatë kabllorë dhe subjekte të autorizuar për shërbim programi audioviziv mbështetur në rrjet satelitor ose online nga 113 subjekte në total.

6.3 Subjektet e paautorizuara nga AMA që janë identifikuar në transmetim

NR	Emërtim OSHMA	Zona
1	Subjekt kabllor në fshatin Shaqisht të Komunës Zharrës	Fier
2	Subjekt kabllor në komunën Levan	Fier
3	Subjekt kabllor në komunën Topojë	Fier
4	Subjekt kabllor në komunën Seman	Fier
5	Subjekt kabllor në komunën Libofsh	Fier
6	“Tv kabllor AVN”	Fier
7	“Tv kabllor Multivizion”	Kavajë
8	“Tv kabllor ALTE”	Durrës
9	“Subjekt kabllor në komunën Velabisht	Berat
10	Subjekt kabllor në fshatin Vodicë	Berat
11	Subjekt kabllor në fshatin Fushë Peshtan, komuna Vertop	Berat
12	Subjekt kabllor fshati Karkanjoz, komuna Roshnik	Berat

13	Subjekt kabllor fshati Dranovicë	Berat
14	Subjekt kabllor fshati Donofros	Berat
15	Subjekt kabllor komuna Gorican	Berat
16	Subjekt kabllor komuna Syzez	Berat
17	Subjekt kabllor komuna Karbunare	Lushnje
18	Subjekt kabllor në autostradën Rrogozhinë – Kavajë	
19	Subjekt kabllor në komunën Sodoholl	Dibër
20	Subjekt kabllor në qytetin e Kuçovës	
21	Subjekt kabllor në fshatin Magjatë të komunës Perondi	
22	Subjekt kabllor në qytetin e Poliçanit	
23	“TV Kabllor Voskopi”	
24	“TV kabllor Alfa”	
25	Subjekt kabllor shoqëria “Fibernet” shpk	

6.4 Çështjet gjyqësore

E drejta për të investuar pushtetin gjyqësor, lidhur me aktet administrative të administratës shtetërore, nga palët e prekura nga këto vendime, është një e drejtë ligjore, që e ka bërë AMA-n palë në shumë procese gjyqësore.

Për t’u evidentuar është numri i madh i proceseve gjyqësore me objekt zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të cilat e kanë rënduar financiarisht AMA-n. Po ashtu, janë kundërshtuar gjyqësisht vendimet e AMA-s për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj subjekteve, vendimet për heqjen/pavlefshmërinë e licencës, vendimet për miratimin e detyrimeve të ndryshme ndaj subjekteve audiovizive (Must Carry) etj.

Pasqyrimi në mënyrë të përmblodhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tre shkallët e gjyqësorit dhe të përfunduara gjatë vitit 2014, pasqyrohet në shtojcën nr. 4.

6.5 Vendimmarrja e AMA-s për detyrimet e mbartjes

AMA me vendimin nr. 4, datë 26.03.2014 “Për vendosjen e detyrimit të mbartjes të programeve kombëtare nga rrjetet e komunikimeve elektronike kabllore të subjekteve të autorizuar për ripërsëritjen e programeve audio dhe audiovizive në këto rrjete”, ka miratuar detyrimin e mbartjes së programeve kombëtare të RTSH-së (programit të parë), TV “Klan” dhe TV “Top Channel” nga rrjetet e komunikimeve elektronike kabllore të subjekteve të autorizuar për ripërsëritjen e programeve audio dhe audiovizive, në zonat që nuk mbulohen me sinjal nga ofruesit e shërbimit të programit kombëtar audiovizive. Nga ana tjetër, AMA me shkresën nr. 630 prot., datë 27.03.2014 dërguar gjithë subjekteve televizivë kabllorë, në kundërshtim me vendimin e miratuar, ka nxitur ritransmetimin e këtyre programeve edhe në zonat e mbuluara normalisht me sinjal nga subjektet kombëtare, duke shkaktuar mungesë korrektësie, serioziteti, dhe mbi te gjitha përplasje ligjore të panevojshme kundrejt subjekteve të prekur nga ky vendim.

Ky vendim është konsideruar i padrejtë nga subjektet TV “Klan” dhe TV “Top Channel”, të cilët kanë kërkuar në gjykatë shfuqizimin e vendimit të mësipërm të AMA-s, duke pretenduar se vendimi është marrë në kundërshtim të dispozitave procedurale të ligjit pa kryer konsultim publik, akti është nxjerrë si pasojë e interpretimit të gabuar të nenit 87 të ligjit nr. 97/2013, akti administrativ është nxjerrë mbi një bazë faktike të pasaktë e të gabuar si dhe është i paplotë dhe i pazbatueshëm.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4244, datë 18.07.2014 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të AMA-s nr. 4. datë 26.03.2014 të sipërcituar duke arsyetuar se AMA ka vepruar përtej kompetencës së caktuar me ligj lidhur me vendosjen e detyrimit të mbartjes, si dhe në vendimmarrjen e saj nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit, sipas të cilit ndërhyrja për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar duhet të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet.

AMA ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe çështja është ende në fazën e shqyrtimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

7 MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE

7.1 Burimet Njerëzore

7.1.1 Politikat e Rekrutimit

AMA në bazë të ligjit nr. 97/2013 operon me administratën e saj, e cila realizon të gjithë veprimtarinë e nevojshme administrative. Kriteret e punësimit në Autoritetin e Mediave Audiovizive bazuar në ligjin organik kryhen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Për periudhën raportuese, në politikat e ndjekura të rekrutimit të nëpunësve të administratës përgjithësisht nuk janë respektuar kërkesat ligjore. Konkretisht:

- Nuk janë respektuar kërkesat ligjore për procedurat e rekrutimit, përzgjedhjes, periudhës së provës, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të administratës së AMA-s;
- Nuk janë respektuar kërkesat ligjore për përfundimin e marrëdhënieve të punës dhe largimin nga shërbimi civil;
- Nuk është bërë brenda afatit ligjor deklarimi i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktuale që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 të sipërcituar;
- Nuk janë zbatuar kërkesat ligjore për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë;
- Për emërimet e nëpunësve nuk janë respektuar kërkesat specifike bazuar në përshkrimet e pozicioneve të punës dhe nevojave të institucionit.
- Dosjet e personelit rezultojnë me mangësi në dokumentacion në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Nuk janë zbatuar politika institucionale që do t’i shërbenin rritjes së kapaciteteve profesionale të nëpunësve të institucionit.

Si pasojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe shkeljes së dispozitave ligjore në këtë fushë, shkelje të konstatuara si rezultat i shqyrtimit gjyqësor, AMA-s i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme financiare. Kështu për periudhën 2010-2014, fatura financiare që AMA ka shlyer për proceset gjyqësore me objekt marrëdhënie pune është 21.832.542 lekë.

Informacion i hollësishëm për proceset gjyqësore me objekt marrëdhënie pune jepet në shtojcën nr. 5.

Një tjetër çështje që kërkonte zgjidhje emergjente ka qenë miratimi i ndryshimeve të nevojshme strukturore për t’iu përgjigjur me efikasitet nevojave dhe kapaciteteve që kërkon procesi i kalimit në transmetimet numerike.

Pas plotësimit të vendeve vakante në Këshillin e Autoritetit, AMA në muajin dhjetor 2014 miratoi disa ndryshime në strukturën e institucionit duke shtuar funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Ankesave të parashikuara shprehimisht në ligjin nr. 97/2013. Këto ndryshime i janë përcjellë për miratim Komisionit Për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2014, janë zhvilluar 6 mbledhje të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në 4 prej të cilave të zhvilluara deri në prill 2014 kanë marrë pjesë 4 anëtarët e mbetur të AMA-s. Pas plotësimit të trupës vendimmarrëse janë zhvilluar 2 mbledhje. Në njëërën prej tyre kanë marrë pjesë 6 anëtarët e AMA-s, ndërsa në mbledhjen e fundit nuk kanë marrë pjesë z. Sami Nezaj dhe znj. Suela Musta.

7.1.2 Trajnimet

Gjatë vitit raportues nuk është bërë asnjë përpjekje minimale nga strukturat e institucionit për të siguruar trajnimet e nevojshme të stafit të Autoritetit. Asnjë zë nga buxheti i AMA-s nuk i është dedikuar trajnimit të nëpunësve, të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e performancës, rritjen e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit, si dhe respektimin e normave të etikës nga punonjësit e administratës së Autoritetit.

Një element tjetër që vlen për t'u theksuar është edhe bashkëpunimi me organizmat evropiane, ndërkombëtare dhe rajonale. Në aktivitetet e zhvilluara nga këto organizma, kanë marrë pjesë anëtarë të Këshillit Drejtues të AMA-s, të cilëve nuk i është kërkuar një raportim mbi çështjet që janë diskutuar apo qëndrimet që janë mbajtur në këto takime, si rrjedhojë, informacioni mbi këto aktivitete është i vakët. Një rëndësi e veçantë do t'i jepet dokumentimit të takimeve ku do të marrim pjesë nëpunësit e AMA-s dhe anëtarët e Këshillit.

7.1.3 Sistemimi në ambiente të reja

Siç është theksuar edhe në raportet vjetore të viteve të kaluara, ambientet aktuale ku ushtron veprimtarinë AMA, i janë kthyer me vendim gjyqate, një subjekti privat. Që në vitin 2009, ka përfunduar gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ku është vendosur që AMA detyrohet të lirojë e dorëzojë godinën e ish-hotel Drinit. Për më tepër, godina është e amortizuar në konstruksionin e saj dhe në rrjetin elektrik që është i pasigurt; mjediset e punës janë të vogla, me pajisje të amortizuara, me hapësira të papërshtatshme për ruajtjen e teknologjisë dhe dokumentacionit.

Nevoja për zgjidhjen përfundimtare të kërkesës së AMA-s për sistemimin në ambiente të reja pune kërkon një zgjidhje të shpejtë, pasi ambientet aktuale i janë kthyer, me vendim gjyqate, një subjekti privat.

Në këto kushte AMA, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave ka nisur përpjekjet për të siguruar ambiente për ushtrimin e aktivitetit.

7.1.4 Marrëdhëniet me jashtë dhe publikun

Gjatë vitit 2014, AMA ka vijuar bashkëpunimin me organizmat evropiane, ndërkombëtare e rajonale, me qellim njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të përafuar me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, direktivave dhe Rekomandimeve të BE-së si dhe shkëmbimi në vijimësi i përvojave dhe praktikave evropiane në fushën e mediave audiovizive.

Një aspekt tjetër i veprimtarisë së AMA-s mbetet komunikimi aktiv dhe i vijueshëm me publikun, i cili synon marrjen dhe pasqyrimin e opinioneve, mendimeve e ankesave lidhur me zbatimin e ligjshmërisë të Kodit të Transmetimit, respektimin e normave etike e morale nga subjektet e licencuara prej AMA-s, si dhe informimin për ecurinë e procesit të digjitalizimit në vendin tonë. Disa prej veprimtarive kryesore të zhvilluara nga AMA, gjatë vitit 2014, kanë qenë konferencat me temë mbi digjitalizimin dhe diskriminimin, mbrojtjen e të miturve dhe respektimin e privatësisë e dinjitetit të individit në transmetimet audiovizive.

7.2 Menaxhimi i burimeve financiare

7.2.1 Aktiviteti ekonomiko-financiar

AMA me vendimin nr. 17, datë 28.10.2013 “Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2014” ka miratuar fondin limit si dhe strukturën e shpenzimeve të detajuar në zërat si **më poshtë**:

Nr.	Emërtimi	Në milionë lekë
1	Të ardhura të parashikuara në vitin 2014	115.6
2	Shpenzime korrente	107.7
3	Shpenzime për investime	5

7.2.2 Realizimi i treguesve financiarë

Struktura e zërit “Të ardhura”, e parashikuar dhe e realizuar për vitin 2014, paraqitet si vijon:

në milionë lekë				
Nr	Zërat e të ardhurave	Plani	Realizimi	Në %
1	Të ardhura nga pagesat vjetore për licencë	110,10	88,93	81
2	Të ardhura nga pagesa për marrjen e licencës dhe rinovimin e licencës	1,50	0,77	51
3	Të ardhura nga përpunimi i dokumenteve të licencës	1,60	2,02	126
4	Të ardhura nga përfitimet si agent tatimor	1,20	0,85	71
5	Të ardhura nga interesa bankare për depozitat në bankë	1,00	0,21	21
6	Të ardhura të tjera	0,20	0,21	105
	Total të ardhura	115,6	92,97	80,4

7.2.3 Problematika të natyrës financiare

AMA është institucion juridik publik i cili administron fondet e veta sipas legjislacionit në fuqi. Për realizimin e funksioneve të veta AMA shfrytëzon të ardhurat e siguruar nga burimet e financimit të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013. Burimi kryesor i të ardhurave të institucionit janë të ardhurat nga pagesat vjetore për licencë dhe/ose autorizime.

Pavarësisht se kuadri ligjor është i mirëpërcaktuar, praktikisht AMA është gjendur para situatave të vështira ekonomike, pasi të ardhurat nuk janë realizuar sipas parashikimeve vjetore.

- Problemi më i shpeshtë i hasur në këtë periudhë ka qenë mosshlyerja e detyrimeve financiare nga subjektet e licencuara/autorizuara. Rezulton se shumë subjekte janë debitorë ndaj buxhetit të shtetit dhe AMA-s, detyrime që shtrihen përtej vitit 2014. Vlera totale e detyrimeve shkon në rreth 106 milion lekë.
- AMA nuk ka respektuar detyrimet ligjore për heqjen e licencës/autorizimit për subjektet debitorë por është mjaftuar me njoftime shkresore drejtuar subjekteve për shlyerjen e detyrimeve.
- Shumica e subjekteve audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor për depozitimin e pasqyrave financiare.
- Nuk është respektuar detyrimi ligjor për mbajtjen e kamatëvonesave për subjektet të cilat nuk kanë shlyer detyrimet brenda afateve.

7.2.4 Realizimi i zërit “Të ardhura”

Për vitin 2014, realizimi i të ardhurave nga pagesat për licencë është në masën 88,927,030 lekë ose 81%, nga 110,100,000 lekë të planifikuara. Nga realizimi i të ardhurave të mësipërme, 49,115,029 lekë janë të ardhura nga faturat e pagesave për licencë për vitin 2014 dhe 39,812,001 lekë nga të ardhurat e faturuara në vitet paraardhëse. Gjatë vitit 2014, janë shlyer 928,668 lekë për sanksionet me gjobë.

Nga 258 operatorë, të cilët operojnë në fushën e mediave audiovizive, kanë kryer pagesat për licencë 170 prej tyre, nga të cilët, 40 operatorë radiofonikë, 37 operatorë televizivë, 88 operatorë me kabëll, 1 operator ofrues shërbimi online, 2 operatorë ofrues shërbimi satelitor dhe 2 operator platforme numerike satelitore. Në bazë të periudhës së licencimit, në vitin 2014 kanë paguar detyrimet e viteve të kaluara 73 operatorë, më konkretisht, 2 platforma numerike, 38 operatorë më kabëll, 17 operator televizivë dhe 16 operatorë radiofonikë.

Të ardhurat për marrjen dhe rinovimin e licencës janë realizuar në shumën 770.000 lekë ose 51% e shumës së planifikuar. Të ardhurat nga përpunimi i dokumenteve për marrjen dhe rinovimin e licencave janë realizuar në shumën 2,020,000 lekë ose 125%.

7.2.5 Realizimi i zërit “Shpenzime”

Për periudhën janar–dhjetor 2014, realizimi i shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

në milionë lekë

Faqe | 33

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Plan	Realizim	%
1.	Shpenzime rrjedhëse (operative)	107,7	71,25	66
	a) Paga e kontribute	56,2	52,67	94
	b) Shpenzime materiale e të tjera	51,5	18,58	36
2.	Shpenzime për investime	5	0,30	6
	a) Blerje pajisje zyre	2	0,10	5
	b) Blerje pajisje kompjuterike dhe operacionale	3	0,22	7

7.2.6 Shpenzime rrjedhëse

Shpenzimet rrjedhëse janë realizuar në masën prej 71,249,807 lekë ose 66% e shumës së planifikuar. Realizimi në këtë masë ka ardhur për arsye se:

- Realizimi i zërit *“Paga e kontribute të tjera”* në masën 94% ka ardhur si rrjedhojë e lëvizjes së punonjësve, si dhe nga pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për paaftësi të përkohshme në punë.
- Realizimi i zërit *“Shpenzime materiale e të tjera”*, në masën 52 %, është si më poshtë:
 - Shpenzimet për *“Honorare”*, janë realizuar në masën 665,260 lekë ose 27%, për arsye të 3 vendeve vakante të AMA-s gjatë vitit 2014.
 - Shpenzimet për zërin *“Dieta”*, janë realizuar në masën 3,281,561 lekë nga 8,000,000 lekë të parashikuara.
 - Nuk është realizuar zëri *“Materiale e shërbime të tjera”*, janë realizuar në masën 708,070 lekë nga 6,000,000 lekë të parashikuara. Ashtu siç jemi shprehur edhe në argumentimet e mësipërme, realizimi në këtë masë ka ardhur kryesisht nga mos funksionimi i AMA-s, për mungesë kuorumi.
 - Në vitin 2014, në zërin *“Detyrime dhe kompensime legale”*, ishte parashikuar një fond prej 10,000,000 lekë. Në bazë të titujve ekzekutive, të vendimeve gjyqësore, sipas proceseve gjyqësore ku AMA (KKRT) ka qenë palë, janë likuiduar 5,013,156 lekë.

7.2.7 Pasqyrat financiare të operatorëve radiotelevizivë

Në zbatim të nenit 33 nr. të ligjit 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, AMA ka kërkuar nga operatorët radiotelevizivë, të cilët kanë pasur aktivitet për vitin 2013, të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, të hartuara në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe të konfirmuara me numrin dhe datën e dërgesës postare.

Në mbyllje të vitit 2014, nga 258 operatorë, të cilët kanë pasur aktivitet gjatë vitit 2013, kanë dorëzuar pasqyrat financiare vetëm 122 operatorë, ku përfshihen 33 operatorë radio, 37 operatorë televizivë, 51 operatorë televizivë me kabëll dhe 1 operatorë televizivë numerikë. Situata financiare e operatorëve që kanë dorëzuar pasqyrat financiare rezulton si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Operatorë me fitim	Operatorë me rezultat 0	Operatorë me humbje	Gjithsej operatorë
1	Operatorë radiofonikë	23	2	8	33
2	Operatorë audiovizive	28	2	7	37
3	Operatorë me kabëll	44	--	7	51
4	Operatorë numerikë	1			1
	Total	96	4	22	122

Nga analiza e treguesve financiarë të këtyre operatorëve radiotelevizivë rezulton se peshën specifike të të ardhurave e zë zëri “Të ardhurat nga reklamat”, dhe/ose nga pagesat e abonentëve. Ndërkohë, rezulton se të ardhurat e deklaruar në bilancet kontabël për vitin 2013 janë gjithsej 8,991,692,543 lekë në vit, ndërsa shpenzimet e deklaruar në bilancet kontabël, janë gjithsej 8,474,709,796 lekë ose 94 % e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti.

8 Veprimtaria e AMA-s, nëntor 2014 – janar 2015

- Është përgatitur një pasqyrë e qartë e problematikave që mbart çdo OSHMA, me karakter juridik, teknik dhe financiar bazuar në kërkesat që parashikon legjislacioni në fuqi.
- Është përmirësuar ndjeshëm situata financiare e institucionit si rrjedhojë e një procesi intensiv komunikimi dhe sensibilizimi me OSHMA-të lidhur me detyrimet financiare të prapambetura.
- Janë bërë takime konsultative me njohës, studiues, specialistë të fushës, drejtues organizatash që mbështesin median, pedagogë të fakultetit të gazetarisë, me qëllim shqyrtimin e sa më shumë ideve dhe opinioneve mbi mënyrën se si duhet të funksionojë institucioni. Kjo filozofi e re drejtimi do të shërbejë për të ngritur ura të reja komunikimi dhe do të krijojë një mjedis bashkëpunues midis autoritetit të medias dhe ekspertëve në fushën e medias.
- Prej muajit janar 2015, AMA ka nisur një proces konsultimi me subjektet historikë kombëtare dhe ata me eksperiencë në transmetimet numerike për përshpejtimin e ndryshimeve përkatëse në rregulloren e licencimit sipas procedurës “*beauty contest*” dhe zhblokimin e procesit të licencimit.
- Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike kemi insistuar në përshpejtimin e takimeve në kuadër të aktivitetit të Komitetit Ndërinstitucional dhe Sekretariatit Teknik për koordinimin sa më efikas për zbatimin e angazhimeve të përcaktuara në strategjinë e kalimit në transmetimet numerike.
- Është zhvilluar takim zyrtar i posaçëm me operatorët historikë e kombëtarë për t’u njohur nga afër me problematikën e tyre si dhe me pritshmëritë që ata kanë për procesin e digjitalizimit.
- Është kryer vlerësimi teknik nga AMA mbi projektin e optimizimit të përdorimit të frekuencave, paraqitur nga operatorët historikë në vend. Ky vlerësim më pas i është dërguar Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike. Vlerësim për këtë studim është dërguar dhe nga ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit).
- Janë hartuar specifikimet teknike të aparateve marrës tokësorë, kabllorë dhe IPTV, të cilët do t’i bashkëngjiten projektvendimit “Për miratimin e standardeve teknike të dekoderëve për transmetime numerike tokësore dhe transmetime kabllorë”, duke synuar standardizimin dhe unifikimin e këtyre pajisjeve me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve si dhe përmirësimin e teknologjisë së transmetimeve audiovizive.
- Është përgatitur drafti për ndryshimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”, duke specifikuar më qartë kriteret dhe kushtet për marrjen e këtij autorizimi. Si rrjedhojë e futjes në tregun audioviziv të shërbimeve IPTV dhe OTT, sjellja e tyre brenda kuadrit ligjor e bën të domosdoshëm përditësimin e këtyre dispozitave.
- Është zhvilluar një takim me të gjithë operatorët kabllorë për të njohur problematikën e tyre dhe për të krijuar një klimë komunikimi sa më të hapur dhe transparente, ku është theksuar rëndësia dhe

ndërgjegjësimi që duhet të kenë këta operatorë për zbatimin e ligjit dhe rregulloreve të institucionit. Në veçanti, janë zhvilluar edhe takime zyrtare me 30 subjekte, të cilët kanë pasur problematika të theksuara me Autoritetin për sa i përket kontroleve të ushtruara ndaj tyre në periudhën paraardhëse.

- Është përgatitur draft rregullorja mbi “Procedurat e rinovimit të licencave të operatorëve privatë audio dhe audiovizivë, të licencuar sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Janë intensifikuar takimet me faktorin ndërkombëtar si BE, KE, OSBE për të krijuar një tjetër klimë bashkëpunimi dhe janë hedhur themelet për një pasqyrim sa më transparent të punës së AMA-s. Gjatë këtyre takimeve ka dalë në pah vullneti i këtyre organizmave për të mbështetur Autoritetin në sfidat e hasura në përmbushjen e detyrimeve madhore të përcaktuar në ligj. Konkretisht, me Këshillin e Evropës po hartohet një agjendë për trajnimin profesional të stafit të AMA-s.
- Është rishikuar struktura organizative e institucionit, paraqitur më parë në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe është propozuar kryerja e riorganizimit strukturor të institucionit në bashkëpunim me OSBE-në, e cila do të asistojë Autoritetin me ekspertizën e nevojshme dhe eksperiencën evropiane në këtë fushë.
- Është raportuar në Këshillin e AMA-s gjendja e detajuar e çdo drejtorie, si dhe gjendja financiare e institucionit.
- Ka nisur procedura për zgjedhjen e anëtareve të Këshillit të Ankesave, ku janë vendosur kriteret e përgjithshme dhe të posaçme për personat që do e përbëjnë atë.
- Është duke u punuar mbi faqen e re zyrtare të Autoritetit, në të cilën parashikohet të paraqiten të gjitha aktivitetet e institucionit ku synimi kryesor është transparenca e proceseve dhe vendimmarrjeve të AMA-s, si dhe konsultimi i gjerë me grupet e interesit.
- Është ngritur grup pune për përgatitjen e dosjes së aplikimit për financimin e studios së monitorimit. Studio e monitorimit është infrastrukturë thelbësore në zhvillimin normal dhe të plotë të proceseve kryesore të institucionit. Synohet automatizimi i proceseve të monitorimit të subjekteve në përputhje me standardet ndërkombëtare, në mënyrë që:
 - të përshtatet funksionalisht duke u modernizuar për t’iu përgjigjur procesit të kalimit të transmetimeve audiovizive nga analoge në numerike;
 - të ofrohet ekspertizë dhe precedent i ngjashëm nga vende të tjera për të dizajnuar dhe arregtuar Studio sipas standardeve bashkëkohore dhe në përputhje me dinamikën e tregut shqiptar të transmetimeve;
 - shërbimi dhe aktualizimi i të gjithë sistemit informatik në Studio të ketë zgjidhje të qëndrueshme dhe të përgjegjshme për personelin që është pjesë e tij, duke shmangur rastet e gabimeve, ose

dëmtimeve që sjellin pasoja të rënda në database, si rasti i përmendur i fillimit të muajit nëntor 2014;

- përshtatja e personelit të Studios së Monitorimit me risitë e inventarit teknologjik dhe proceseve të reja, si dhe të synohet që monitorimi dhe skedimi i përmbajtjeve të ketë në fokus dhe elementët paraprakë të analizës apo vlerësimeve për to.
- Është zhvilluar një takim dypalësh me Autoritetin e Mediave në Kosovë (KPM) për hartimin e një protokolli bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i eksperiencave, praktikave më të mira dhe përafrimit të legjislacionit në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive.
- Është paraqitur një kërkesë zyrtare drejtuar Këshillit të Ministrave, për pajisje me zyra të reja. Ambientet aktuale ku ushtron veprimtarinë AMA, i janë kthyer me vendim gjykatë, një subjekti privat. Në këtë vendim AMA detyrohet të lirojë e dorëzojë sendin objekt gjykimi (godinën e ish-hotel Drinit) në kushtet e posedimit të paligjshëm.
- Perspektiva e Drejtorisë së Programeve lidhet me kalimin e saj nga pozitat e qëndrimit pasiv ndaj problematikës (duke u angazhuar më shumë kur ka ankesa apo kërkesa nga jashtë institucionit për përmbajtjen e programeve të subjekteve audiovizive) në pozitat aktive. Kjo do të arrihet dhe përmes:
 - verifikimit të grilave programore dhe përmbajtjeve kryesore për të cilat subjektet audiovizive janë angazhuar në momentet e aplikimit për licencë ose autorizim, ose gjatë procesit të rimarrjes së tyre;
 - kryerja e studimeve/analizave të fokusuara për aspekte të rëndësishme të përmbajtjeve programore: mbrojtja e të miturve, transmetimi i filmave ose i programeve me përmbajtje seksi, dhune etj., pa shenja paralajmëruese dhe në fasha orare të papërshtatshme, aksesit për personat me aftësi të kufizuara etj.
 - përqendrimi tek trajtimi i rasteve të keqpërdorimit të gjuhës shqipe, banalitetet dhe qëndrimet joetike në përmbajtjet e programeve/spektakleve argëtuese etj.